



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 2, datë 07.01.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

V E N D O S I :

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DIBËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Murat Lleshi dhe Rexhep Karaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, çështjen penale me:

Të pandehur: {...};

Akuza: “Vjedhje me armë” e kryer në bashkëpunim dhe për veprën penale “Mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga nenet 140 e 25 dhe 278/1 të Kodit Penal”;

Të pandehur: {...};

Akuza: “Vjedhje me armë” e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 140 dhe 25 i Kodit Penal”;

Të pandehur: {...};

Akuza: “Përkrahje e autorit të krimit”, parashikuar nga neni 302/2 i Kodit Penal.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Rexhep Karaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Dhunë në familje”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PUKË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Gentian Jahjollli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen

gjqësore me kërkues{...}; palë e tretë: {...}; Objekti: “Heqje zotësie për të vepruar të shtetases {...} dhe caktimin si kujdestare të shtetases {...}”

2. GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË VLORË

1. Gjyqtarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, Ema Shaholli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, çështjen civile me palë paditëse: {...}; i paditur: {...}; person i tretë: {...}, {...}; Objekti: “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së furnizimit me material mjekimi për vitin 2013, nr. 1344 prot., datë 29.04.2013 dhe rregullimin e pasojave ligjore., etj.”

GJYKATA E APELIT DURRËS

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Valbona Vata, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen civile me palë paditëse{...}; të paditur: {...}; Objekt: “Detyrim njohje pronar”.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtarja e skemës së delegimit e caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; Objekti: “Rishikim i vendimit penal nr. 144, datë 28.04.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë”.

2. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me palë paditëse: Trashëgimtarët {...}; i paditur: {...}; Objekti: “Sigurim padie”.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtaret e Gjykatës së Apelit Vlorë, Klodiana Gjyzari dhe Margarita Buhali, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me palë paditëse: {...}; të paditur: {...}; person i tretë{...}; Objekti: “Përjashtim nga ekzekutimi i titullit ekzekutiv”.

2. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Engert Pëllumbi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen gjyqësore me ankues{...}; Objekti: “Kundërshtim vendimi të prokurorisë për mosfillim procedimi”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Nazmi Troka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen gjyqësore me ankues{...}; Objekti: “Kundërshtim i vendimit të prokurorisë për pushim procedimi”.

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, Enton Dhimitri (relator), Irena Brahimi dhe gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër, Sokol Pina, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; pjesëmarrës{...}; Objekti: “Lirim me kusht”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, Dritan Banushi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}: {...};

Objekti: “Kërkesë për pushimin e çështjes penale me nr. 434 të vitit 2019, të regjistruar për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Asim Vokshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...} Akuza: “Trafikim të narkotikëve”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Asim Vokshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me ankues: {...}; Objekti: “Kundër vendimit për mosfillim të procedimit penal nr{...}

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Artur Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; Objekti: “Lirim para kohe me kusht”.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Artur Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; Objekti: “Pushimin e procedimit {...}, për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 dhe 290/3 të Kodit Penal”; person nën hetim{...}; trashëgimtarët e viktimës{...}.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Asim Vokshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me ankues: {...}; Objekti: “Kundërshtim vendimi mosfillimi të procedimit penal datë 13.05.2020 të prokurores{...}në lidhje me materialin kallëzues nr. 175, datë 12.05.2020”; Objekt shqyrtimi: “Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit Olsi Xhavella”.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Zegjine Sollaku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit, çështjen civile me palë paditëse: {...}; të paditur: {...}; personi i tretë: {...}; Objekti: “Shfuqizimi i vendimit {...} për përfundimin e kandidimit të {...}, në vendin vakant për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme shpallur nga Presidentii i Republikës në datën 22.11.2019. Detyrimin {...}të marrë sërish në vlerësim kandidaturën e paditëses {...}, duke i bërë vlerësimin e kritereve profesionale dhe pikëzimin në përputhje me ligjin”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR